



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2023:205039

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05499405

P.nr.47/2023

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjiilan - Dega në Novobërdë, gjyqtari Sadri Krasniqi, me procesmbajtësen Donjeta Zenuni, në lëndën penale kundër të akuzuarit N. Gj.nga Fshati Bushincë, komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 pra.2, në lidhje me par.1, nënpar.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (më tutje shkurtesa KPRK-së), të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av.Sherif Sherifi nga Gjiilani, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjiilan, PP.II.nr.1223/2023, të datës 27.09.2023, në prani të palëve më dt. 18.03.2024, shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërsa më datën 25.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I a k u z u a r i :

N. Gj., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati M., dhe e ëma Zh. e lindur P., i lindur më datë 02.06.1975, në Bushincë, Komuna e Novobërdës, ku edhe jeton, me nr. personal 1500333126, serb, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i katër fëmijëve, i pa punësuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, sipas deklaratës së tij nuk ka qenë i dënuar më parë për veprë tjetër penale dhe nuk udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale.

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse:

Më datë 19.Korrik.2023, rreth orës 07:15, në fshatin Busincë, komuna e Novobërdës, i pandehuri N.Gj., me përdorimin e atqasëshëm të dhunës, me dashje i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit Z. K., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje rreth pagesës së korrjes së grurit, i poandehuri e sulmon fizikisht duke e goditur me ulëse të plastikës, në pjesën e fytyrës, me

crast i pandehuri me veprimet e veta i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit, i cili për shkak të natyrës së lëndimeve është detyruar të kërkojë ndihmë mjekësore në Emergjencën Spitalit Regjional të Gjilanit.

-me çka ka kryer veprën penale; Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 pra.2, lidhur me par.1, nënpar.1.4 të KPRK-së,

Gjykata në bazë të të njëjtit nen dhe neneve 4, 38, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe 72, paragrafi 1 pika 1.6 të KPRK-së, lidhur me nenin 242, 364, 449 dhe 452 të KPPRK-së, të akuzuarin N.Gj. e,

G J Y K O N

Me dënim me kusht,

- dënim **me burgim** në kohëzgjatje prej **4 (katër) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, në rast se i akuzuari kryen vepër tjetër penale, brenda afatit të verifikimit atëherë dënimi me kusht ka për t'iu revokuar në dënim me burg efektiv.

I dëmtuari Z. K. nga fshati Tirincë, Komuna e Novobërdës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Njashtu i akuzuari obligohet që në kuptim të nenit 36, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin, të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzën PP.II.nr.1223/2023, të datës 27.09.20231, ka kërkuar që ndaj të akuzuarit N. Gj. nga Fshati Bushincë, komuna e Novobërdës, të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprës penale: Lëndim i

lehtë trupor nga neni 185 pra.2, në lidhje me par.1, nënpar.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe pas vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës, konstatoi se aktakuza është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar kundër të akuzuarit për datë 18.03.2024, në të cilën seancë gjyqësore pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i akuzuari N.Gj. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, njëherit deklaroi se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, nga i akuzuari përkitazi me veprën penale me të cilat akuzohet sipas aktit akuzues.

Gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë vullnetarisht edhe atë pas konsultimit të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkëlqje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari N. Gj., me dashje ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 pra.2, në lidhje me par.1, nënpar.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për të cilën vepër penale, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës.

Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë, gjykata nuk është lëshuar fare në administrimin e provave të propozuara si në aktakuzë, por drejtë është shkuar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokuroja e shtetit Kujtesa Fazliu në fjalën përfundimtare deklaroi se në shqyrtimin e sotëm fillestar i pandehuri N. Gj., e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë edhe atë pas konsultimit me avokatin e tij, pranimin e fajësisë i njëjti e bëri vullnetarisht pa ndikim të dhunës, me pranimin e fajësisë u vërtetua gjendja faktike ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës lëndore, me që u vërtetua gjendja faktike mbetet pranë aktakuzës dhe propozimeve të cilat e njëjta i përmban. Andaj kërkon nga gjykata që i akuzuari të shpallet

fajtor dhe të njëjtin ta dënojë me dënim të paraparë me ligj, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese po ashtu edhe ato rënduese, të propozuara si në aktakuzë, në mënyrë që dënimi i shqiptuar të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale.

I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit Z. K., në fjalën përfundimtare deklaron se, nuk i bashkangjitet ndjekjes penale, ndërsa e rezervon të drejtën për parashtrimin e kërkesës pasurore juridike.

Mbrojtësi sipas detyrës zyrtare av.Sherif Sherifi, në fjalën përfundimtare deklaron se me që i akuzuari e ka pranuar fajësinë në seancën e shqyrtimit fillestar duke e kuptuar natyrën dhe pasojat e këtij pranimi dhe se ky pranim është bërë në mënyrë vullnetare pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, i propozon gjykatës që të marrë aktvendim me të cilin do të aprovohet pranimi i i fajësisë nga ana e të akuzuarit. Nëse gjykata aprovon pranimin e fajësisë kërkon nga e njëjta që me rastin e caktimit si dhe shqiptimit të llojit të sanksionit penal ndaj të akuzuarit të marrë apasysht rrethanat lehtësuese dhe atë: pranimin e fajësisë si rrethanë veçanërisht lehtësuese, faktin se i akuzuari më herët nuk ka qenë i dënuar dhe se është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, se i dëmtuari nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale, se i akuzuari është mbajtës i vetëm i familjes, ashtu që gjykata ti merr parasysh të gjitha këto rrethana dhe më pastaj të marrë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë mbi caktimin e llojit dhe lartësisë e sanksionit penal. Andaj i propozon gjykatës që ndaj të njëjtit të shqiptohet një dënim i kushtëzuar i cili dënim do të arrij qëllimin e tij ashtu siç kërkohet me Kodin penal, por nëse gjykata gjen se ndaj të njëjtit duhet të shqiptohet dënim tjetër dhe pa paragjykuar llojin e atij dënimi konform dispozitave ligjore me të cilat lejohet dënimi me burg në dënim me gjobë, akuzuari pajtohet që dënimi me burg t'i zëvendosohet në dënim me gjobë.

I akuzuari N. Gj. në fjalën përfundimtare deklaron se e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të avokatit të tij, e pranoj fajësinë, ka gabuar, është penduar, kërkon falje për rastin që ka ndodhur, po ashtu i kërkon falje edhe të dëmtuarit, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe i premtton gjykatës se më nuk do të kryej këso vepra penale apo të tjera, të tilla. Andaj kërkon nga gjykata që nëse eventualisht gjen prova dhe e shpall fajtor të ketë parasysh gjendjen e tij të vështirë ekonomike në të cilën jeton, sepse si mbajtës i familjes jeton nga ndihma sociale në mënyrë që të shqiptoj dënim sa më të butë konform ligjit.

Gjykata me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të akuzuarit për këtë vepër penale të kryer, vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në shqiptimin e drejtë dhe meritot të dënimit ligjor. Për këtë rast si rrethana lehtësuese gjykata pati parasysh pranimin e fajësisë nga i akuzuari, gjendjen e tij jo të mirë ekonomike në të cilën jeton, sepse si mbajtësi familjes jeton nga ndihma sociale, shih

shkresën e QPS në Novobërdë me nr. 23/2024 të datës 19.03.2024, faktin se është penduar thellë për veprën penale të kryer, ka gabuar, i premtun gjykatës se më nuk do të kryej këso vepra, si dhe as vepra të tjera penale, i vie keqpër rastin qëka ndodh, të dëmtuarit i kërkon falje publike, po ashtu i dëmtuari nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale. Ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veqanërisht rënduese për të akuzuarin, andaj duke pasur parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, peshën e veprës penale të kryer dhe mënyrën e kryerjes së saj, i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj bazueshëm mund të pritët që ky dënim do të ndikoj pozitivisht në përmirësimin e të akuzuarit, do të ketë ndikim edukativ edhe ndaj qytetarëve tjerë që në të ardhmen mos të kryejnë vepra penale, sikundër që do t'i kontribuojnë disiplinës dhe përgjegjësisë më të madhe të qytetarëve në përgjithësi.

I dëmtuari Z. K. nga fshati Tirincë, Komuna e Novobërdës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjykata, bazuar në nenin 449 paragrafi 2, nën paragrafi 2.6 të KPPRK-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për të paguar paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzetë euro), si dhe 20 €, për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Pas shpalljes së aktgjykimit, në kuptim të nenit 367 të KPPRK-së palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2023:205039, 25.03.2024

G j y q t a r i

Sadri Krasniqi, d.v.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.